



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

### THIRRJE PËR EKSPERTË TË JASHTËM

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), kërkon një ekspert të jashtëm për hartimin e projekt-preventivit për përshtatjen e disa mjediseve të brendshme në pronësi të AKEP, duke siguruar në të njëjtën kohë shfrytëzimin maksimal të hapësirës ekzistuese

### TERMAT E REFERENCËS

#### Qëllimi

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, kërkon një ekspert të jashtëm për hartimin e projektit dhe preventivit për përshtatjen e disa mjediseve të brendshme në pronësi të AKEP, duke siguruar në të njëjtën kohë shfrytëzimin maksimal të hapësirës ekzistuese.

#### Detyrat

Eksperti i kualifikuar, ngarkohet me:

1. hartimin e projektit dhe preventivit, për përshtatjen e disa mjediseve të brendshme në pronësi të AKEP, me qëllim akomodimin e zyrës së Arkivë-Protokollit të AKEP.
2. Preventivi duhet të përfshijë zërat e nevojshëm, volumet dhe kostot e punës të nevojshme për këtë qëllim.
3. Bashkëpunojë ngushtë me stafin e AKEP, me qëllim realizimin në kohë të objektit të thirrjes dhe përshtatjen e ambienteve sipas nevojave të institucionit.

#### **Dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga aplikuesit për ekspert të kualifikuar në fushën e mobilimit të ambienteve të brendshme:**

1. Curriculum Vitae (CV) të ekspertit, ku të përfshihen të dhëna të detajuara mbi angazhimin në punë të ngjashme;
2. Licencë profesionale (kopje e njehsuar me origjinalin);
3. Portofol të punëve të realizuara;
4. Kopje të ID.

**Kriteret e vlerësimit për përzgjedhjen e ekspertit të kualifikuar/arkitektit:**

- *Eksperiencia mbi 3 vjet si ekspert në projektimin e të ambienteve të brendshme.* 40 pikë
  - *Portofol i punëve të realizuara* 60 pikë
- 

Llogaritja e vlerës së kontratës së shërbimit do të kryhet në përputhje me përcaktimet e VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Aplikuesit duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 06 tetor 2025, ora 16.30, pranë zyrës së Arkiv – Protokollit, të AKEP, në adresën Rruga “Reshit Çollaku“, Tiranë.

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**